

FLETË PUNE NGA INFORMATIKA PËR KLASËN 6

Arsimtarja: **Xheneta Bela**

TABELAT faqe(189-192)

Programet për shkruarje mundësojnë rregullimin e tekstit në tabelë. Në tabelë mund të rregullohen, për shembull, të dhënat personale të nxënësve (emri, mbiemri, klasa, data e lindjes, adresa e shtëpisë etj.), të dhënat për orarin e orëve mësimore etj. Tabelat përbëhet prej **rreshtave** dhe **kolonave**. Prerja e rreshtit dhe kolonës është një drejtkëndësh që quhet **qeliza e tabelës**.

| | | |
|--|--------|--|
| | | |
| | qeliza | |
| | | |
| | | |


Diagram illustrating a table structure. The word "kolonat" (columns) is written above the table, and "rreshtat" (rows) is written vertically to the left of the table. The word "qeliza" (cell) is written inside one of the cells.

VENDOSJA DHE RREGULLIMI I TABELËS NË DOKUMENTIN TEKSTUAL

Pamja e tabelës mund të rregullohet me zgjedhje të lartësisë dhe gjerësisë të kolonave, vendosjen e vijave kufi tare me stil, trashësi dhe ngjyrë të ndryshme, bashkimin dhe ndarjen e qelizave nga tabela, shtimin dhe fshirjen e rreshtave dhe kolonave etj

PUNA ME MENYNË PËR TABELA

Me tabela punohet nëpërmjet menysë Table




Domethënia e urdhrave të shënuara nga menyja janë:

- 1 **Insert** futja e tabelës me zgjedhje e numrit të rreshtave dhe kolonave,
- 2 **Delete** –fshirja e gjithë tabelës, rreshtit të selektuar, kolonës së selektuar apo qelizave nga tabela,
- 3 **“Split Cells”** –Ndarja e qelizës së zgjedhur në dy apo më tepër qeliza,
- 4 **“Merge Cells”** - bashkimi i disa qelizave fqinje në një qelizë etj.

PUNA ME VEGLAT E SHIRITIT PËR PUNË ME TABELA

Pjesa më e madhe e urdhrave në këtë meni është paraqitur me vegla të shiritit për vegla **“Tables and Borders” (Tabela)**. Shumë shpejt dhe lehtë krijohet dhe rregullohet dukja e tabelës me veglat e shiritit me vegla.



Funksioni i veglave nga ky shirit me vegla është siç vijon:

1. lapsi për vizatim të tabelës me dorë të lirë,
2. goma për fshirje të rreshtave, kolonave apo vijave të vizatuara.
3. Vegla për zgjedhje të llojit të vijave në tabelë,
4. Zgjedhja e trashësisë së vijës,
5. Zgjedhja e ngjyrës së vijës,
6. Zgjedhja e mënyrës së vizatimit të vijës së zgjedhur,
7. Ngjyra e prapavijës së qelizave në tabelë,
8. Zgjedhja e numrit të rreshtave dhe kolonave në tabelë,
9. Bashkimi i rreshtave apo kolonave të selektuara në tabelë,
10. Qeliza e zgjedhur ndahet në numër të zgjedhur të rreshtave dhe kolonave,
11. Rreshtat e zgjedhur rregullohen me gjerësi të njëjtë
12. Kolonat e selektuara rregullohen me gjerësi të njëjtë,
13. Shkruarja vertikale e tekstit në qelizë.

DETYRË

1. Krijohet tabelë në programin WORD me të dhënat e nxënësve të klasës tënde: Emri dhe mbiemri, ditëlindja dhe e-mail adresa si në fotografi faqe **191** ne liber.
2. Krijohet tabelë në programin WORD për orarin e orëve mësimore si në fotografi faqe **192** ne liber.

Detjrat ti dergoni sikur file ne WORD .